



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS PËR VIZITËN NË QENDRËN E PARABURGIMIT NË PRISHTINË

Për:

- Z. Abelard Tahiri, Ministër
Ministria e Drejtësisë**
- Z. Qemajl Marmullakaj, Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Drejtësisë**
- Z. Uran Ismaili, Ministër
Ministria e Shëndetësisë**
- Z. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Shëndetësisë**
- Z. Rashit Qalaj, Drejtor i Përgjithshëm
Policia e Kosovës**
- Z. Nehat Thaqi, Drejtor i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës**
- Z. Milazim Gjocaj, Drejtor
Departamenti i Shëndetësisë në Burgje**
- Z. Hestet Loku, Drejtor
Qendra e Paraburgimit në Prishtinë**

Prishtinë, më 22 nëntor 2019

HJRJE

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 11 shtator 2019, e vizitoi Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: QPP).

MKPT-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, si dhe institucionet psikiatrike dhe të ato të kujdesit social.

Në QPP, përveç të paraburgosurve, vendosen edhe një numër i vogël i të dënuarve. Kapaciteti i Qendrës është për 300 persona. Gjatë vizitës që realizoi MKPT-ja në QPP, ishin të vendosur 103 të paraburgosur dhe 25 të dënuar.

Qëllimi i vizitës

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.

Përbërja e grupit monitorues

1. Grupi monitorues përbëhej prej një këshilltari të lartë juridik për parandalim të torturës, një këshilltare juridike për parandalim të torturës, një psikologe-këshilltare dhe një punëtoare sociale-këshilltare.

Bashkëpunimi i QPP-së me MKPT-në gjatë vizitës

2. Gjatë vizitës që realizoi MKPT-ja në QPP, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës (në tekstin e mëtejme: ShKK) dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (në tekstin e mëtejme: DShB) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje të papenguar në të gjitha vendet e vizituara dhe iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën, si dhe iu mundësuan intervistat me personat e dënuar dhe me persona të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe pa praninë e personelit shëndetësor.

Informimi për të drejtat e të burgosurve

3. Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese (më tej: Rendi Shtëpiak) përcakton obligimet e institucioneve korrektuese që, menjëherë pas pranimit, të sigurojnë kushte që i burgosuri të njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet e tij. Më tej, Rendi Shtëpiak përcakton se *Rendi Shtëpiak* dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (tani e tutje: LESP) janë në dispozicion të të burgosurve gjatë gjithë kohës. I burgosuri i cili nuk di shkrim dhe lexim, njoftohet gojarisht për të drejtat dhe obligimet.¹ MKPT, gjatë vizitës, vërejti se në dispozicion të të burgosurve janë Rendi Shtëpiak dhe dokumentet e tjera relevante, përmes të cilave të burgosurit njoftohen për të drejtat dhe obligimet e tyre.

¹ Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 20.

Keqtrajtimi fizik

4. MKPT-ja, gjatë vizitës në QPP, intervistoi një numër të konsiderueshëm të të burgosurve dhe nuk mori asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike të ushtruar nga zyrtarët korrektues apo për sjellje të autoriteteve të burgut, të cilat do të përbënin shkelje të dinjitetit të të burgosurve. Përveç kësaj, MKPT-ja vërejti se ekziston një klimë pozitive e marrëdhënieve dhe komunikim i mirë interaktiv ndërmjet të burgosurve dhe zyrtarëve korrektues, si dhe ndërmjet personelit shëndetësor dhe të burgosurve.
5. Po ashtu, shumica e të paraburgosurve të intervistuar nga MKPT-ja u shprehen në favor të trajtimit të mirë nga Policia e Kosovës me rastin e arrestimit dhe gjatë fazës sa ishin në mbajtje.
6. Megjithatë, MKPT-ja, gjatë vizitës, hasi në dy të paraburgosur të cilët pohuan se janë keqtrajtuar fizikisht nga Policia e Kosovës gjatë arrestimit dhe gjatë qëndrimit në stacionin policor në Fushë Kosovë. Tek të paraburgosurit D. K. dhe D.K., MKPT-ja vërejti shenja të lëndimeve trupore në fytyrë dhe në kokë. Lidhur me këtë, MKPT-ja vizitoi Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë, ku mori dokumentacionin relevant. Nga dosja e të paraburgosurve vërehet se ata iu nënshtruan kontrolleve mjekësore në Qendrën Klinike Universitare. Atje u dërguan nga policia para se të pranoheshin në Qendrën Rajonale të Mbajtjes.
7. Më 20 shtator 2019, MKPT-ja vizitoi stacionin policor në Fushë Kosovë, ku mori dokumente shtesë lidhur me rastin, siç janë formularët e raportimit për përdorim të forcës fizike, raportet e zyrtarëve policorë nga vendi i ngjarjes, si dhe raportet mjekësore në rastin e dy zyrtarëve policorë, të cilët ishin në vend të ngjarjes dhe të cilët u përballen me rezistencë aktive nga të paraburgosurit në fjalë dhe pësuan lëndime trupore. Sipas njoftimit nga zyrtarët policorë dhe nga konstatimet në raportet mjekësore, njëri nga zyrtarët policorë, i cili ishte në vend të ngjarjes, si pasojë e lëndimeve të pësuar, ende është në pushim mjekësor.
8. MKPT-ja u njoftua se i tërë dokumentacioni relevant, me një raport, u dërgua tek Komisioni për Vlerësimin e Përdorimit të Forcës Fizike i Policisë së Kosovës. Përmes këtij raporti, MKPT-ja kërkon nga komisioni në fjalë që ta njoftojë me të gjeturat lidhur me përdorimin e forcës fizike në rastin në fjalë nga zyrtarët policorë.

Kushtet e akomodimit

9. LESP-ja shprehimisht përcakton se i dënuari ka të drejtë për strehim, i cili u përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike.² Më tej ligji përcakton: *“Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.”*³

² Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 1.

³ Ligji nr. 05/L0-129, neni 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

10. MKPT-ja vërejtë se qelitë ku akomodohen të burgosurit kanë dritë të mjaftueshme natyrore, hapësirë banimi e cila shkon përtej standardit të përcaktuar me LESP dhe me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (tani e tutje: KPT).⁴ MKPT-ja gjatë vizitës vërejtë se dy qeli janë adekuate dhe në dispozicion për të burgosurit me aftësi të kufizuara.
11. Megjithatë, pavarësisht faktit se QPP-ja është objekt i ri, ka filluar të dëmtohet dukshëm për shkak të problemeve me përcimin e ujit nëpër objekt. MKPT-ja, gjatë vizitës, vërejtë se ka filluar të paraqitet lagështia nëpër korridore dhe nëpër qeli.
12. Në pavijonet ku mbahen të paraburgosurit, në krahë të caktuar qelitë janë të pajisura me dushe dhe të paraburgosurit mund të bëjnë dushe sa herë që duan. Në pjesët tjera ku qelitë nuk kanë dushe, por ekzistojnë dushet e përbashkëta, të paraburgosurit mund të bëjnë dushe tri herë në javë. Të dënuarit mund të bëjnë dushe sa herë që duan.

Ushqimi

13. LESP përcakton të drejtën e të burgosurve për ushqim të përshtatshëm, në tri shujta për çdo ditë, për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tyre, të cilat duhet të jenë të llojllojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, aq sa është e mundur, kërkesave të tij fetare dhe kulturore.⁵
14. Më tej ligji përcakton se personi i dënuar, i cili kryen punë të rënda, personi i sëmurë, gruaja shtatzënë, ose ajo e cila ka lindur fëmijë, kanë të drejtë për ushqim të caktuar nga mjeku edhe për ushqim dietal.⁶ **Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua nga personeli shëndetësor se ka mungesë të ushqimit dietal.**

Regjimi

15. Në QPP asnjë i paraburgosur nuk është i angazhuar në punë. Në rastin e të paraburgosurve, angazhimi i tyre në punë varet nga leja e gjykatës. Ndërsa janë të angazhuar në punë 17 të dënuar, të cilët angazhohen për punë në kuzhinë, në kopsht, në oborr, në bibliotekë dhe në mirëmbajtje të objektit. Të burgosurit kanë në dispozicion dy orë shëtitje gjatë ditës, siç parashihet me LESP.⁷ QPP-ja ka katër shëtitore dhe dy fusha sportive, të cilat nuk janë në përdorim. Të paraburgosurit shumicën e kohës, respektivisht 22 orë, i kalojnë në qelitë e tyre në mungesë të angazhimeve në punë apo në aktivitete, siç janë sporti, edukimi, trajnimet etj.
16. MKPT-ja vëren se, sa i përket angazhimit në punë të të paraburgosurve, neni 199, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale përcakton si në vijim: *“I paraburgosuri mund të kryejë punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t'i lejohet të punojë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e dëmtojë procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për këtë në marrëveshje me drejtorinë e institucionit.”*

⁴ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449/>.

⁵ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39 par. 1.

⁶ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 2.

⁷ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 37.

17. Ndërsa neni 200, paragrafi 1, i LESP-së, lidhur me angazhimin e të paraburgosurit në punë, përcakton si në vijim: *“I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësive ekonomike të cilat gjenden në rrethin e institucionit korrektues përkatës pas marrjes së pëlqimit të gjykatës kompetente.”*
18. Po ashtu, Rregullat e Mandelës përcaktojnë të drejtën e të paraburgosurit për të punuar. Në Rregullin 116 të Rregullave të Mandelës shprehimisht theksohet: *“Të paraburgosurit duhet ti ofrohet mundësia të punojë, por nuk duhet ti kërkohet të punojë. Nëse ai/ajo përcaktohet që të punojë, ai/ajo duhet të paguhet.”*
19. Në raportin e KPT-së për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2015, i cili ishte publikuar në vitin 2016, KPT-ja, lidhur me regjimin për të paraburgosurit, kishte shprehur shqetësimin që, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve, të paraburgosurit shumicën e kohës e kalojnë në qelitë e tyre, përveç dy orëve të shëtitjes në ditë, duke shikuar TV dhe duke luajtur me letra.
20. Përmes këtij raporti, KPT-ja u kishte rekomanduar autoriteteve kompetente në Republikën e Kosovës, si në vijim: *“KPT, ri-përsërit rekomandimin që autoritetet të angazhohen që të rrisin aktivitetet jashtë qelisë për të paraburgosurit në të gjitha institucionet të cilat KPT i vizitoi, dhe në të gjitha institucionet tjera të Shërbimit Korrektues të Kosovës ku një gjë e tillë është e përshtatshme.”* Më tej KPT-ja thekson: *“Sa më e gjatë që është periudha e paraburgimit, aq më shumë duhet të zhvillohet regjimi i cili u ofrohet atyre. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që edhe numri i personelit, ku një gjë e tillë është e nevojshme, të rritet.”*⁸
21. **MKPT-ja konsideron se, bazuar në legjislacionin në fuqi, Rregullat e Mandelës dhe në rekomandimet e KPT-së, autoritetet kompetente duhet të bëjnë përpjekje që të rriten angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit, jo vetëm në QPP, por edhe në qendrat e tjera të paraburgimit, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.**

Incidentet ndërmjet të të burgosurve

22. Autoritetet e burgut kanë obligime pozitive për ta parandaluar dhunën ndërmjet të të burgosurve, për të cilët ata janë përgjegjës. Bazuar në dokumentacionin relevant, pohimet e drejtorisë dhe të të burgosurve, gjatë këtij viti në QPP nuk janë regjistruar incidente serioze ndërmjet të burgosurve, përveç fjalosjeve ku për të zgjidhur problemet drejtoria përdori ndërmjetësimin dhe pajtimin.

Kujdesi shëndetësor

23. Neni 43 i Ligjit nr. 05/l-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari do t'i gëzojë të njëjtat standarde të kujdesit shëndetësor, të cilat janë në dispozicion në komunitet. LESP-ja më tej përcakton se këto shërbime mjekësore të burgosurve u ofrohen pa pagesë. Njësia shëndetësore në QPP përbëhet prej gjashtë infermierëve dhe prej dy mjekëve të përgjithshëm, të cilët punojnë me orar të plotë. Ndërsa stomatologu dhe psikiatri janë në dispozicion dy herë në javë. Sipas njoftimit të fundit nga Njësia shëndetësore, psikologu është me orar të rregullt 8 orë në ditë.

⁸ Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë, publikuar në shtator 2016, paragrafi 46. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

24. Shërbimet e tjera specialitike kryhen në institucionet shëndetësore: në spitalet rajonale dhe në ato të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). MKPT-ja nuk mori asnjë ankesë nga të burgosurit sa u përket shërbimeve mjekësore që u ofrohen në QPP. Përveç kësaj, të burgosurit u shprehën në favor të një trajtimi shumë të mirë nga personeli mjekësor, si në aspektin e shërbimeve të ofruara mjekësore, ashtu edhe në aspektin e komunikimit interaktiv dhe respektimit të dinjitetit të tyre njerëzor.

Prezenca e të burgosurve me sëmundje mendore

25. Prezenca e të burgosurve me sëmundje mendore vazhdon të jetë sfidë për qendrat e paraburgimit dhe për ato korrektuese, për shkak të mungesës së kapaciteteve për t'i akomoduar të burgosurit e kësaj kategorie në institucione përkatëse shëndetësore. MKPT-ja, gjatë vizitës në QPP, u njoftua se për shkak të kapaciteteve të limituara në Institutin e Psikiatrisë Forenzike, në QPP ka të burgosur, të cilët, për shkak të gjendjes shëndetësore, nuk duhet të jenë në QPP.
26. Sipas personelit shëndetësor, janë shtatë të burgosur të cilët nuk mund të menaxhohen në këtë njësi shëndetësore. Pesë nga ta tanimë janë të shtrirë në Institutin e Psikiatrisë Forenzike, ndërsa pritet edhe dërgimi i një tjetri.
27. Në këtë drejtim, MKPT-ja vëren se neni 43 i Ligjit nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: *“Personi i dënuar të cilit nuk mund t'i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues dërgohet në spitalin e institucionit korrektues, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjetër për përkuqjesje shëndetësore.”*
28. MKPT-ja vëren se standardet e KPT-së përcaktojnë si në vijim: *“Një i burgosur i sëmurë mendor duhet të mbahet dhe ti ofrohet kujdesi mjekësorë në një mjedis spitalor që është i pajisur përshtatshëm dhe që ka personelin e trajnuar siç duhet. Ai mjedis mund të jetë një spital psikiatrik civil ose një mjedis psikiatrik të pajisur posaçërisht brenda sistemit të burgut.”*⁹
29. Rregullat Evropiane të Burgjeve, në Rregullin 12.1, përcaktojnë si në vijim: *“Personat të cilët vuajnë nga sëmundjet mendore të cilat nuk janë kompatible me akomodimin në burg duhet të akomodohen në institucionin e paraparë veçanërisht për këtë qëllim.”*¹⁰
30. Rregullat e Mandelës, në Rregullin 109, përcaktojnë se të burgosurit me probleme mendore nuk duhet të mbahen në burgje, por duhet të bëhen përpjekje që ata të transferohen në institucione përkatëse sa më shpjet që të jetë e mundur.
31. MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme që këta persona të mbahen në institucione përkatëse, qoftë në ndonjë njësi të veçantë psikiatrike brenda burgut, në ndonjë spital apo në ndonjë institucion psikiatrik civil.

⁹ Standardet e KPT-së, pjesë nga Raporti i 3-të i Përgjithshëm, paragrafi 43, publikuar në vitin 1993. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943>.

¹⁰ Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 47.1. Shih në: <https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ae>.

Rëndësia e kontrolleve mjekësore për të burgosurit e sapopranuar

32. KPT-ja vazhdimisht thekson rëndësinë e ekzaminimit mjekësor të të burgosurve të sapopranuar, veçanërisht në institucionet të cilat përbëjnë pikë hyrjeje në sistemin e burgjeve. Një ekzaminim i tillë është esencial, veçanërisht për t'i parandaluar vetëvrasjet dhe përhapjen e sëmundjeve transmetuese (siç janë tuberkulozi, hepatiti B/C, HIV).
33. Sipas KPT-së, shërbimet mjekësore të burgut po ashtu mund të japin kontribut të rëndësishëm në parandalimin e keqtrajtimit fizik, gjatë periudhës menjëherë para burgosjes, domethënë, në periudhën kur personat janë në mbajtje nga agjencitë e zbatimit të ligjit, përmes regjistrimit sistematik dhe me kohë të lëndimeve dhe, kur kjo është e përshtatshme, përmes sigurimit të informatave për autoritetet relevante.¹¹
34. Më tej, standardet e KPT-së përcaktojnë se të sapopranuarit në burg apo në qendër të paraburgimit duhet t'i nënshtrohen kontrollit mjekësor jo më larg se 24 orë nga koha e pranimit në institucion.¹²
35. LESP-ja¹³ dhe Praktika Standarde e Veprimeve¹⁴ e DShB-së përcaktojnë obligimin e autoriteteve kompetente që i burgosuri i sapopranuar t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda 24 orëve nga momenti i pranimit.
36. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës¹⁵, Rregullat Evropiane të Burgjeve¹⁶ dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.¹⁷
37. Bazuar në pohimet e të burgosurve dhe në dokumentacionin relevant, të sapopranuarit, brenda 24 orëve i nënshtrohen kontrolleve mjekësore, në pajtim me LESP-në dhe me Praktikën Standarde të Veprimi të DShB-së.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

38. Sa i përket konfidencialitetit të shërbimeve mjekësore, MKPT-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe me personelin shëndetësor, konstaton se këto shërbime jepen nën kushte të cilat respektojnë konfidencialitetin, respektivisht jepen pa prezencë të zyrtarëve korrektues, përveç në raste kur prezenca e tyre kërkohet nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor.
39. Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me Praktikën Standarde të Veprimit,¹⁸ e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë; me LESP-në¹⁹; me standardet e

¹¹ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 26-të i Përgjithshëm, paragrafi 72, në: <https://rm.coe.int/168070d0c8/>

¹² Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Suedi, 2015, paragrafi 81. Shih në: <https://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22sort%22:%5B%22CPTDocumentDate%20Descending,CPTDocumentID%20Ascending,CPTSectionNumber%20Ascending%22%5D,%22CPTSectionID%22:%5B%22p-swe-20150518-en-25%22%5D%7D>

¹³ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale, neni 31.

¹⁴ Praktika Standarde e Veprimeve, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standar-de-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

¹⁵ Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf/

¹⁶ Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2-i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d/>

¹⁷ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika 27, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf/

KPT-së,²⁰ si dhe me aktet ndërkombëtare, siç janë: Rregullat e Mandelës²¹ dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.²²

Masat disiplinore

40. Sipas legjislacionit në fuqi, dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve janë: qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vetmia.²³ Kurse në rastin e të paraburgosurve, mund të shqiptohen dënimet si në vijim: kufizimi apo ndalimi i vizitave apo i korrespondencës, përveç kontakteve me avokatin mbrojtës, me Avokatin e Popullit dhe me misionet diplomatike.
41. Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua nga drejtori i QPP-së se gjatë këtij viti në asnjë rast nuk u zbatua masa disiplinore e vetmisë. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit lidhur me shqiptimin e masave disiplinore nga drejtori i QPP-së.

Kontakti me botën e jashtme

42. MKPT-ja konsideron se kontaktet me botën e jashtme, veçanërisht vizitat nga familja apo nga të afërmit e tjerë, janë të rëndësishë thelbësore në kontekstin e rehabilitimit social të të burgosurve.
43. Legjislacioni në fuqi,²⁴ për rastet e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korrespondencës (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat më së paku një orë, si dhe kanë të drejtë për një vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Sipas drejtorit të QPP-së, të paraburgosurit mund ta kenë një vizitë në dy javë, ndërsa të dënuarit mund t'i kenë katër vizita në muaj, të cilat zgjasin nga një orë.
44. Sa u përket thirrjeve telefonike, neni 60 i LESP-së përcakton se i dënuari ka të drejtë të bëjë thirrje telefonike. Në rastet e të paraburgosurve, këto telefonata autorizohen nga gjykata kompetente. Bazuar në informatat e siguruar nga drejtori i QPP-së dhe nga pohimet e të paraburgosurve, atyre u lejohet nga një telefonatë në javë, e cila është subjekt i lejes së gjykatës kompetente. Ndërsa në rastet e të dënuarve nuk ka kufizime.
45. MKPT-ja vizitoi edhe sallën e vizitave familjare, e cila ofron kushte të kënaqshme për të pranuar vizita familjare. Salla e vizitave familjare për të dënuarit ofron mundësinë e kontaktit të drejtpërdrejtë ndërmjet të dënuarit dhe të personave të cilët e vizitojnë. Ndërsa në rastet e të paraburgosurve, situata është ndryshe, ndërmjet të paraburgosurit dhe vizitorëve ka barriera të cilat e pamundësojnë kontaktin e drejtpërdrejtë.

¹⁸ Praktika Standarde e Veprimt, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimt-n%C3%AB-DShB.pdf/>

¹⁹ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 49.

²⁰ Standardet e KPT-së, publikuar në vitin 2018, paragrafët 50 dhe 51. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943/>.

²¹ Rregullat e Mandelës, Rregulli 26, pika 2, në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf/.

²² Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika A, Rregulli 19, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf/.

²³ Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

²⁴ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

46. Në këtë drejtim, MKPT-ja vëren se KPT-ja, në raportin për vizitën në Ukrainë²⁵, trajton çështjen e vizitave të mbyllura, të cilat bëjnë ndarjen fizike përmes xhamit pleksi, ndërmjet të burgosurit dhe personave të cilët e vizitojnë. Me këtë rast, KPT-ja u rekomandoi autoriteteve ukrainase që rregulloret relevante të ndryshohen ashtu që të gjithë të burgosurve, përfshirë edhe ata të paraburgosur, t'u mundësohet të pranojnë vizita në kushte të arsyeshme dhe të hapura, ndërsa përdorimi i objekteve të mbyllura për vizita do të duhej të ishte më shumë përjashtim sesa rregull.
47. Më tej KPT-ja theksoi se vizitat e tipit të mbyllur duhet të jenë gjithmonë të bazuara dhe të arsyetuara mirë, si dhe të bazuara në vlerësimin individual të rrezikut potencial, të cilin e paraqet i burgosuri i caktuar. **Prandaj, MKPT-ja inkurajon autoritetet kompetente që në frymën e këtij rekomandimi t'i shqyrtojnë mundësitë që këto vizita të zhvillohen në kushte më të hapura dhe duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut individual që përbën i burgosuri i caktuar.**

Procedura e parashtrimit të ankesave

48. Standardet e KPT-së theksojnë rëndësinë e sistemit efektiv të parashtrimit të ankesave dhe e konsiderojnë atë si garanci themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit.²⁶
49. Neni 91 i LESP-së përcakton hollësisht procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo me lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK). Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe ministri i Drejtësisë.²⁷
50. MKPT-ja vërejtë se në dispozicion të të burgosurve në QPP gjenden kutitë e ankesave, të vendosura nga ShKK-ja dhe ato të DShB-së. Po ashtu, ata mund t'i drejtojnë ankesë Avokatit të Popullit edhe përmes linjës telefonike pa pagesë (informatat për linjën telefonike janë të vendosura në kutitë e ankesave), përmes postës së rregullt, e cila, sipas LESP-së nuk i nënshtrohet kontrollit nëse i adresohet Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, si dhe përmes familjarëve të tyre.
51. MKPT-ja vërejtë se të burgosurve në QPP u ofrohet mundësia adekuate për parashtrim të ankesave dhe të kërkesave, drejtori i shqyrton ato dhe u dërgon përgjigje të burgosurve, në pajtim me LESP-në. Po ashtu, QPP-ja regjistron të gjitha ankesat dhe kërkesat e të burgosurve në dosjet e tyre administrative. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit sa i përket së drejtës për të parashtruar ankesë.

²⁵ KPT, Raporti me rekomandime për vizitën në Ukrainë në dhjetor 2017, publikuar më 6 shtator 2018, paragrafi 102. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16808d2c2a>.

²⁶ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 27-të i Përgjithshëm, paragrafi 68. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16807bc668>.

²⁷ Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: "Në ankimin e paraqitur, drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën e shkruar."

Personeli i QPP-së dhe çështje të ndërlidhura me sigurinë

52. Sipas drejtorit, mungesa e numrit të mjaftueshëm të zyrtarëve korrektues mbulohet me angazhimin e personelit korrektues nga institucionet e tjera korrektuese. Personeli korrektues dhe ai civil janë të të dyja gjinive. Gjatë këtij viti, sipas dokumentacionit të prezantuar, del se janë zhvilluar gjithsej 27 trajnime për zyrtarët e QPP-së. Përveç trajnimeve relevante, të cilat janë mbajtur në Republikën e Kosovës, disa zyrtarë korrektues të QPP-së morën pjesë në një vizitë studimore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku vizituan burgje të cilat menaxhohen nga Shërbimi Korrektues Amerikan.

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Drejtësisë:

- Të shtohen aktivitetet jashtë qelisë për të paraburgosurit në QPP, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale dhe në pajtim me LESP-në, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.
- Të burgosurve në QPP t'u ofrohet ushqimi dietal sipas rekomandimit të mjekut.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,


Hilmi Jashari

Avokat i Popullit